



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017  
Nr. ref.: RK 1174/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI136/16**

Parashtrues

**Vllaznim Bytyqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Pml. nr. 192/2016, të 3 tetorit 2016**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Vllaznim Bytyqi, me banim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [Pml. nr. 192/2016] i 3 tetorit 2016, i Gjykatës Supreme të Kosovës. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar datën se kur e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Pml. nr. 192/2016] të 3 tetorit 2016, të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesë Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 25 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 14 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 20 dhjetor 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.
8. Më 18 tetor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës është i punësuar në pozitën “Zyrtar i lartë për financa” në Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës.
10. Më 4 dhjetor 2014, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur Aktakuzë (PP. II. nr. 6277/14), ndaj parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës penale “Mosraportim ose raportim i rremë i pasurisë i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” nga neni 437 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).



11. Më 16 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [P. nr. 3009/14] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor, duke e dënuar me dënim me gjobë dhe burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajsh. Dënimi me burgim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti, me kusht që i akuzuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, gjatë kësaj periudhe nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Gjykata Themelore në Prishtinë konstatoi se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e Zyrtarit të Lartë për Financa në Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë, ka qenë i obliguar që të deklarojë pasurinë në bazë të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Deklarimin e Pasurisë).
12. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit [P. nr. 3009/14] të 16 korrikut 2015, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me propozimin që *“Gjykata e Apelit në Prishtinë, pasi që t’i rishikojë argumentet e ofruara dhe provat të marrë një vendim të duhur.”*
13. Më 18 shkurt 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 1433/2015] e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [P. nr. 3009/14] të 16 korrikut 2015, të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj ka dhënë përgjigje të detajuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PA1. nr. 1433/2015] të 18 shkurtit 2016, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me propozim që i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
15. Më 3 tetor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 192/2016] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, *inter alia*, thuhet:

*“[...] në kërkesë nuk ka shpjegim se cilat shkelje procedurale apo të ligjit penal janë bërë me aktgjykimet e kundështuara, por vetëm ofrohen në shikim dokumentet, të cilat sipas kërkesës, tregojnë se gjykatat kanë marrë aktgjykime kundërligjore. Konform dispozitës së nenit 436. par. 1 të KPPK-së me rastin e vendosjes për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon meqenëse në rastin konkret nuk është theksuar e as arsyetuar se cilat dispozita janë shkelur, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar.”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi pretendon se, duke e obliguar parashtruesin e kërkesës që të bëjë deklarimin e pasurisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
17. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“klasifikimi arbitrar i pozitës së ekspertit teknik nga AKK, si subjekt i deklarimit nuk është në përputhje me nenin 3, paragrafi 1.1.11 të Ligjit nr. 04/L050 dhe përbën shkelje të së drejtës kushtetuese për privatësi e cila*



*garanton lirinë për qytetarët dhe të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale kur një individ nuk i nënshtrohet deklarimit sikurse definohet me ligj.”*

18. Ndërsa, lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], parashtuesi i kërkesës pretendon se *“kjo e drejtë kushtetuese është shumë e rëndësishme për t’u mbrojtur, posaçërisht në shkallët kur kemi të bëjmë me pozitë të ekspertëve, dhe qfarë është më e rëndësishme kur personat e rinj profesional kanë diplomuar jashtë vendit janë kthyer për të kontribuar për zhvillimin ekonomik të vendit.”*
19. Parashtuesi po ashtu pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], duke mos ofruar asnjë shpjegim lidhur me këtë pretendim specifik.
20. Më tej, lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës pretendon se *“Agjensia Kundër Korrupsionit (AAK) ka shkelur nenin 142, paragrafi 1 deri në 3, të Kushtetutës (Agjencitë e pavarura), e cila garanton pavarësinë e agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi bazuar në ligjet përkatëse të cilat rregullojnë themelimin, veprimtarinë dhe kompetencat e tyre.”*
21. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t’i shfuqizojë vendimet e gjykatave të rregullta, si dhe të urdhërojë kompensimin financiar për shkeljen e së drejtës së privatësisë.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

22. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe të përcaktuara me Rregulloren e punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*(...)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

24. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”*

25. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën si individ dhe në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 192/2016] e 3 tetorit 2016 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike e përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
26. Megjithatë, Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret e parapara në rregullin 36 të Rregullores së punës.
27. Rregulli 36 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafët (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, përcaktojnë:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

*[...]*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Agjencia Kundër Korrupsionit, duke e obliguar parashtruesin e kërkesës që të bëjë deklarimin e pasurisë, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht nenin 36 [E Drejta e Privatësisë], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës. Për më tepër, parashtruesi pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.



29. Gjkata vëren se parashtuesi i kërkesës i bazon pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 36 [E Drejta e Privatësisë] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, duke pretenduar se interpretimi i gabuar i Ligjit për Deklarimin e Pasurisë nga gjykatat e rregullta, ka rezultuar me vendime arbitrare. Gjkata rikujton se ky pretendim ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si i tillë nuk bie nën jurisdiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.
30. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjkatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjkatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në jurisdiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65; gjithashtu rastin: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011 dhe KI86/11, parashtues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012, si dhe KI32/16, parashtues i kërkesës *Ibrahim Svarça*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, par. 38).
31. Gjykata konsideron që kërkesa e parashtuesit nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t’i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtuesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë. (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991; gjithashtu rastin: KI32/16, parashtues i kërkesës *Ibrahim Svarça*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, par. 39, dhe KI88/16, parashtues i kërkesës *N.T.SH. "ELING"*, i 26 janarit 2017, par. 30, si dhe KI72/16, parashtues i kërkesës, *Byroja Kosovare e Sigurimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, par. 30).
32. Gjykata konsideron se, në bazë të fakteve të lëndës konkrete të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet ankimore të parashtuesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetime të detajuara dhe të qarta për vendosjen e tyre, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 192/2016] të 3 tetorit 2016, të cilin parashtuesi i kërkesës e konteston në Gjykatë.
33. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj, arsyetoi se parashtuesi në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk kishte pretenduar se aktgjykimet e kontestuar ishin të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sic kërkohet me ligj, por vetëm kërkoi rishikimin e gjendjes faktike. Rrjedhimisht, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtuesit të kërkesës, Gjykata Supreme konstatoi se “kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon



*meqenëse në rastin konkret nuk është theksuar e as arsyetuar se cilat dispozita janë shkelur, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar.”*

34. Për më tepër, Gjykata më tej vëren se Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [P. nr. 3009/14] të 16 korrikut 2015, dhe Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 1433/2015] të 18 shkurtit 2016, kanë trajtuar gjerësisht çështjen e interpretimit të Ligjit për Deklarimin e Pasurisë dhe kanë dhënë arsyetime të detajuara për të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura para tyre.
35. Përkitazi me pretendimet e ngritura të parashtruesit në kërkesën e tij, Gjykata po ashtu i referohet Aktgjykimit [PA1. nr. 1433/2015] të 18 shkurtit 2016, të Gjykatës së Apelit, e cila, ndër të tjera, arsyetoi se:
- “[...] gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngjitur në mëdyshje siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e të akuzuarit [...] Gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësor i ka administruar provat dhe dëgjimin e dëshmitarëve [...] në cilësinë e zyrtarit të lartë financiar në Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë ( udhëheq me financa) sipas Ligjit nr.04/L-050, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, edhe pse ka qenë i obliguar të bëjë deklarimin e pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare në afatin ligjor prej 01.03. 2014 e deri më datë 31.03.2014, përkatësisht në afatin për deklarimin e rregullt të pasurisë, sipas listës së zyrtarëve të lartë të FSDK-së me dashje dhe i vetëdijshëm për pasojat e mos deklarimit këtë obligim nuk e ka kryer.”*
36. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, gjykatat e rregullta i kishin shqyrtuar, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai kundërshton janë të paraqitura në mënyrë të detajuar dhe se, në bazë të asaj që u tha më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishin të drejta.
37. Gjykata po ashtu vë në dukje se vetëm përmendja e neneve përkatëse të Kushtetutës, me pretendimin se ato janë shkelur pa dhënë shpjegime të mëtjme se si erdhi deri te këto shkelje, nuk mjafton për të ngritur një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
38. Gjykata posaçërisht rikujton faktin se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka ofruar argumente relevante me të cilat do të kishte arsyetuar pretendimet e tij se në ndonjë mënyrë ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret, përveç se ai është i pakënaqur me rezultatin e procedurës. (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005).
39. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje kushtetuese të cilat ai pretendon se janë bërë nga gjykatat e rregullta. (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; gjithashtu rastin KI32/16, parashtrues i kërkesës *Ibrahim Svarça*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 nëntorit



2016, par. 44, dhe KI88/16, parashtues i kërkesës *N.T.SH. "ELING"*, i 26 janarit 2017, par. 33 ).

40. Lidhur me pretendimin e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për *"gëzimin e të drejtave dhe lirive"* që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, këto nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohen nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me *"gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut"*. (shih, *inter alia*, *E.B. kundër Francës [GC]*, par. 47, Aktgjykimi i 22 janarit 2008; *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë*, par. 72, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 7 shtatorit 2013; gjithashtu rastin KI67/16, parashtues i kërkesës *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, par. 128).
41. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse argumentet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtën e garantuar me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtuesi i kërkesës.
42. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 18 tetor 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

*Gresa Caka-Nimani*

Gresa Caka-Nimani



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

*Arta Rama-Hajrizi*